

VENDIM
Nr. 396, datë 20.6.2012

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË
TUFINËS, FAZA II, NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike të Tufinës, faza II, në Bashkinë e Tiranës.
2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 4090 (katër mijë e nëntëdhjetë) m² truall, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendim, e cila është pjesë përbërëse e tij.
3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 30 560 000 (tridhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.
4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.
6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës, për realizimin e këtij projekti.
7. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 4090 (katër mijë e nëntëdhjetë) m² truall, shpronësuar në favor të Bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Bashkia e Tiranës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha